

VENDIM
Nr.82, datë 24.12.2007

**PËR PËRCAKTIMIN PËR VITIN 2008 TË ÇMIMIT UNIK TË SHITJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE, TË PRODHUAR NGA HEC-ET E REJA ME FUQI TË INSTALUAR DERI
NË 10 MW TË DHËNA ME KONCESION**

Në mbështetje të nenit 26 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.27, datë 19.1.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, kreu IV, pika 1 “a” dhe vendimit nr.24, datë 11. 4.2007 “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit unik të energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et e reja me fuqi të instaluar, deri në 10 MW të dhëna me koncesion”, në bazë të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 24.12.2007, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve për përcaktimin e çmimit unik të energjisë elektrike, të prodhuar nga HEC-et e reja me fuqi të instaluar deri në 10 MW të dhëna me koncesion, për vitin 2008,

VENDOSI:

1. Çmimi unik i shitjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga HEC-et e reja me fuqi të instaluar deri në 10 MW të dhëna me koncesion, për periudhën 1.1.2008 deri me 31.12.2008, është 9.37 lekë/kWh.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta